



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:187332

Datë: 26.11.2024

Numri i dokumentit: 06507097

C.nr.1105/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJ., Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit-kundër të paditurit I.Q.nga GJ., Rr.”GJ.F.”nr.65, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.I, avokat nga GJ., e paraqitur kundër të paditurit-kundërpaditësit: E.(XH).B.nga GJ. dhe kundërpadisë së paditësit XH.B.nga GJ. dhe E.(XH).B.nga GJ. të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Y.H., avokat nga GJ., të ushtruar kundër të paditurit I.Q.nga GJ., me objekt kontesti për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, me vlerë të kontestit 5,000.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më datë 18.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit-kundër të paditurit I.Q.nga GJ., dhe detyrohet i padituri-kundërpaditësi E.B.nga GJ., që paditësit-kundër të paditurit, në emër të kompensimit të dëmit jomaterial, të shkaktuar me datë 06.09.2020, si pasojë e lëndimeve të lehta trupore, t’ia paguajë shumat e specifikuara, edhe atë:

- a)Për frikën e përjetuar sipas formave dhe kohëzgjatjeve të intensitetit në shumë prej 1,000.00€
- b)Për të gjitha format e intensitetit të dhimbjeve fizike, shumën prej 1,200.00 €;
- c)Për shëmtimin trupor të shkallës së mesme shumën prej 2,000.00 €, respektivisht shumën e përgjithshme prej 4,200.00€, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditë pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

**II.REFUZOHET** si e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit-kundër të paditurit I.Q.nga GJ., në lartësi prej 800.00€ e kërkuar më tepër se shuma e gjykuar, në emër të dëmit jomaterial edhe atë për dhimbjet fizike shuma prej 300.00€ dhe shëmtimit, shuma prej 500.00€.

**III. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e të paditurit-kundërpaditësit E.B.nga GJ. dhe detyrohet paditësi-kundër i padituri I.Q.nga GJ., që të paditurit-kundërpaditësit, në emër të kompensimit të dëmit jomaterial, të shkaktuar me datë 06.09.2020, si pasojë e lëndimeve të lehta trupore, t’ia paguaj shumat e specifikuara, edhe atë:

- a)Për dhimbje fizike, shumën prej 300.00 €;

b)Për frikën e përjetuar, shumë prej 300.00€, respektivisht në emër të dëmit jomaterial shumë e përgjithshme prej 600.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditë pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

**IV. REFUZHET** si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së të paditurit-kundërpaditësit E.B.nga GJ., përtej shumave të gjykuara edhe ate; për dhimbje fizike shuma prej 800.00€, për frikën e përjetuar shuma prej 570.00€ dhe për ushqim të përforcuar shuma prej 90.00€.

**V. Kërkesat reciproke të paditësit I.Q.nga GJ. e gjykuar në lartësi prej 4,200.00€, në emër të dëmit jomaterial, kompensohen me kërkesën e të paditurit-kundërpaditësit E.B.nga GJ., ashtu që i padituri-kundërpaditësi E.B.detyrohet që paditësit-kundër të paditurit I.Q.nga GJ. t’ia paguaj shumën e mbetur në lartësi prej 3,600.00€, në emër të dëmit jomaterial, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditë pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.**

**VI. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e kundërpaditësit XH.B.nga GJ. dhe detyrohet i padituri I.Q.nga GJ., që kundërpaditësit, në emër të kompensimit të dëmit material, të shkaktuar me datë 06.09.2020, si pasojë e dëmtimeve në veturën e markës “Golf VII”, me targa të regjistrimit 06-110-AB, pronë e kundërpaditësit, t’ia paguajnë shumën prej 430.00€, me kamatë prej 8% në vit, duke filluar nga data 13.10.2023 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditë pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

**VII. Secila palë, i bartë veq e veq shpenzimet e procedurës kontestimore.**

### A r s y e t i m

Paditësi-kundër i padituri I.Q.nga GJ., përmes përfaqësuesit me autorizim, më datë 23.08.2021, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurit-kundërpaditësit E.B.nga GJ., me objekt kontesti kompensimin e dëmit jomaterial, me vlerë të kontestit, 5,000.00 euro. Në padi ka theksuar se me datë 06.09.2020, pas një mosmarrëveshje fillimisht verbale e më pastaj fizike i padituri ka sulmuar fizikisht paditësin duke e goditur me nje dru në kokë të cilit i shkakton lëndime të lehta trupore, të cilat konstatohen nga raporti mjekësor.

I autorizuari i paditësit-kundër të paditurit, në padi, precizimet e padisë dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit-kundër të paditurit ta aprovoj në tërësi si të bazuar për format e dëmit dhe në shumën e precizuar në shqyrtimin kryesor të datës 18.11.2024, ashtu që të detyrohet i padituri-kundërpaditësi E.B.nga GJ. t’ia kompensojë dëmin që e ka pësuar si pasojë e lëndimeve të marra nga sulmi fizik i datës 06.09.2020, dhe atë për dëmin jomaterial, respektivisht në emër të dhimbjeve fizike të të gjitha intensiteteve, shumë prej 1,500.00 euro, në emër të frikës të të gjitha intensiteteve, shumë prej 1,000.00 euro dhe në emër të shëmtimit trupor shumë prej 2,500.00 euro, krejt me kamatë prej 8% në vit.

Përfaqësuesi i të paditurve-kundërpaditësve, në përgjigjen në padi, kundërpadi, shqyrtimin gjyqësor të datës 18.11.2024, dhe fjalën përfundimtare, ka deklaruar se si pasojë e lëndimeve të marra nga paditësi-kundër i padituri pas një mosmarrëveshjeje e sulmon fizikisht të paditurin-kundërpaditësin E.B. duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, për qka kundërpaditësi E. detyrohet të kërkojë ndihmë mjekësore. Po ashtu ka theksuar se paditësi-kundër i padituri, ditën kritike ka dëmtuar automjetin e udhëtarëve Golf, pronë e e babait të tij XH.B., duke i shkaktuar dëm material në automjet në larësi prej 430.00€. Përfaqësuesi i të paditurit-kundërpaditësit në shqyrtimin gjyqësor të dt.13.10.2023, ka zgjeruar kërkesëpadinë në kuptimin subjektiv, qka si palë kundërpaditëse ka paraqitur edhe XH.B., i cili sipas aktgjykimit penal të kesaj gjykate P.nr.739/20, i dt.26.06.2021, paditësi-kundëripadituri, për kompensimin e dëmit material edhe ate demtimin e veturës është obliguar që tani kundërpaditësit, tia kompensojë shumën prej 400.00 euro, mirepo nga aktgjykimi i shkallës së dytë pala e dëmtuar tani kundërpaditësi është udhëzuar në kontest civil. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoi kërkesëpadinë e të paditurit-kundërpaditësit, në tërësi si të bazuar për format e dëmit dhe në shumat e precizuara në shqyrtimin kryesor të datës 18.11.2024, ashtu që të detyrohet paditësi-kundër i padituri t'ia kompensojë dëmin që e ka pësuar si pasojë e lëndimeve të marra nga sulmi fizik i datës 06.09.2020, dhe atë për dëmin jomaterial; emër të dhimbjeve fizike të të gjitha intensiteteve, shumën prej 1,100.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 90.00 euro, në emër të frikës të të gjitha intensiteteve, shumën prej 870.00 euro, këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data 30.10.2023, përkatësisht 21.11.2023, e deri në pagesën përfundimtare. Po ashtu ka precizuar kërkesëpadinë e paditësit XH.B. nga GJ., ashtu që ka kërkuar që të detyrohet i padituri I.Q. nga GJ., që kundërpaditësit në emër të dëmit material të shkaktuar në automjetin e tij të udhëtarëve, t'ia kompensojë shumën prej 430.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 06.09.2020, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit ligjor.

Gjykata, fillimisht me aktvendimin procedural të datës 13.10.2024, e ka lejuar zgjerimin e kërkesëpadisë sa i përket kundërpaditësit XH.B. nga GJ., ndërsa me aktvendimin e saj procedural të marrë në seancën kryesore të datës 18.11.2024, ka lejuar rregullimin e kërkesëpadisë nga palët ndërgjyqëse në mënyrat e specifikuara si më lartë.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e provave nga shqyrtimet gjyqësore, bëri administrimin e provave edhe atë: Aktgjykimi penal P.nr.609.2020, i dt. 02.10.2020, me të cilin i padituri E.B. është shpallur fajtor për veprën penale "Lëndim i lehte trupor" dhe është gjykuar lidhur me këtë veprë, kurse i demtuari-tani paditësi I.Q. për kërkesën pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil, Fotot e lëndimeve të paditësit, Raporti nga Spitali i Përgjithshëm në GJ., me numër protokollit 19900, i dt. 06.09.2020, Raporti nga Spitali i Përgjithshëm në GJ., me numër protokollit 19906, i dt. 06.09.2020, Aktgjykimi penal, i marrë nga Gjykata e Apelit në Prishtinë, me shifrën PA1.nr.1272/21, i dt. 08.07.2022, me të cilin është aprovuar ankesa e paditësit I.Q. dhe është ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gilan, përkitazi me vendimin mbi dënimin lidhur veprat penale "Lëndim i lehtë trupor" dhe "Asgjësim apo dëmtim i pasurisë" ku në dispozitiv të aktgjykimit i demtuari-tani kundërpaditësi i paraqitur XH.B., si pronar i automjetit, lidhur me kërkesën pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil,

Aktgjykimi P.nr.739/2020, i dt. 20.07.2021, Ekspertiza e ekspertit të neuropsikiatrisë, e perpiluar nga ana e ekspertit Dr. SH.K., e pranuar në këtë gjykatë me dt. 25.10.2023, Ekspertiza e Dr. A.L.- ortoped/traumatolog, e pranuar në këtë gjykatë më dt.02.11.2023, për pacientin I.Q. Ekspertiza e Dr. M.J.- ortoped/traumatolog, e pranuar në këtë gjykatë me dt.01.11.2023, lidhur me pacientin E.B., Ekspertiza e Dr. A.C.- psikiatër, e pranuar në këtë gjykatë më dt. 23.11.2023, për pacientin E.B., Fatura me numër 01317, e dt. 19.09.2020, lëshuar në emër të XH.B., për automjetin me targa 06-110-AB, Fatura me numër 0007726, e dt. 17.09.2020, lëshuar në emër të E.B,t, por që nuk është cekur automjeti për te cilin janë blerë këto pjesë. Ekspertiza mbi verësimin e dëmit material në automjet, e perpiluar nga eksperti S.Z., e pranuar në këtë gjykatë me dt. 01.11.2024, Fatura me numër 01317, e dt. 19.09.2020, lëshuar në emër të XH.B., për automjetin me targa 06-110-AB, Fatura me numër 0007726, e dt. 17.09.2020, lëshuar në emër të E.B,t, për të cilin janë caktuar pjesët e blera për automjetin e dëmtuar.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga këto arsye;

Në bazë të Aktgjykimit penal P.nr.609.2020, i dt. 02.10.2020, me te cilin i padituri E.B.është shpallur fajtor për veprën penale "Lëndim i lehte trupor" Aktgjykimit penal, i marrë nga Gjykata e Apelit në Prishtinë, me shifrën PA1.nr.1272/21, i dt. 08.07.2022, me të cilën është aprovuar ankesa e paditesit I.Q.dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gj., përkitazi me vendimin mbi dënimin lidhur veprat penale "Lëndim i lehtë trupor" dhe "Asgjësim apo dëmtim i pasurisë" dhe Aktgjykimit P.nr.739/2020, i dt. 20.07.2021, gjykata ka vërtetuar se me datën 06.09.2020 rreth orës 13;00h, në lagjen „D.“ në Gj., pas një mosmarrëveshje në me të I.Q.dhe E.B,t rreth parkimit të veturës përballë shtëpisë së I.Q., ka ardhur deri tek përleshja fizike dhe rrahja në mes tyre, me q'rast lëndime trupore kanë pësuar që të dy palët si dhe dëmtime në automjetin e markës „V.“ tipi "Golf VII", me targa të regjistrimit 06-110-AB, pronë e XH.B.t-babait të E.B,t, për qka paditësi I.Q.është shpallur fajtor dhe është dënuar për vepër penale „Lëndim i leht trupor" dhe „Asgjësim i pronës së huaj" kurse E.B.është dënuar për vepër penale „Lëndim i leht trupor" dhe palët janë udhëzuar që për realizimin e kërkesës pasurore juridike të inicojnë kontest civil, duke përfshirë këtu edhe të dëmtuarin XH.B.si pronar i automjetit të lartcekur, meqë këto fakte nuk janë kontestuar nga palët ndërgjyqëse, pasi që konfirmohen nga përmbjatja e aktgjykimeve penale të lartëcekura dhe Raporteve mjekësore nga Spitali i Përgjithshëm në Gj., me numër protokollit 19900, i dt. 06.09.2020, Fotot e lëndimeve të paditësit dhe Raporti mjekësor me nr. prot. 19906 i datës 06.09.2020 lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Gj., në emër të E.B.. Po ashtu, ne baze te këtyre dokumenteve publike XH.B.eshte pronar i automjetit te lartcekur dhe ky fakt nuk eshte kontestuar nga palët.

Andaj, sipas gjykatës padia dhe kundërpadia e palëve si dhe kërkesat e tyre bazën juridike e kane në nenin 136 parag.1 të LMD-së, ku është paraparë se "Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij", e po ashtu, me nenin 137 të këtij ligji, është paraparë se " Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)" kurse neni 183 par.1 dhe 2 të po këtij ligji, ka percaktuar se „për dhembjet e shkaktuara fizike, shpirtërore, për zvogëlim të aktivitetit jetësor,

*shëmtimit, cenimit të autoritetit, nderit, lirive ose të drejtave të personalitetit, vdekjes së personit të afërm si dhe frikës, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit e sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla pavarësisht nga dëmi material. Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material si dhe për rëndësinë e saj, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të mirës dhe qëllimit që i shërben ky shpërblim.*

Të gjitha këto dispozita ligjore janë të lidhura me nenin 14 të LPK-së ku është përcaktuar se „Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor” meqë, paditësi dhe i padituri-kundërpaditësi E.B.janë shpallur fajtorë për vepër penale, me qka sigurohet baza juridike e padisë dhe kërkesëpadisë.

Lidhur me lartësinë e dëmit të shkaktuar nga kjo përlëshje fizike e I.Q.dhe E.B,t si dhe dëmtimit të automjetit të udhëtarve të XH.B.t, gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditësit dhe të paditurëve, në cilësinë e provës materiale, ka nxjerr Ekspertizën mjekësore nga lëmia e neuropsikiatrisë, e pranuar në këtë gjykatë me datë 25.10.2023, e hartuar nga Dr. SH.K.-Neuropsikiatër, Ekspertizën mjekësore nga lëmia ortopedisë, e pranuar në gjykatë me datë 02.11.2023, e hartuar nga Dr. Avdilatif Latifi, të cilët në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësit I.Q. kanë dhënë mendimin profesional, përmes ekspertizave të punuara me shkrim, ku sipas tyre paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore nga veprimi mekanik i mjetit të fortë / plagë shqyse në pjesën e përparme të kokës me shëmtim estetik të shkallës së mesme/ për qka paditësi ka pasur frikë dhe dhimbje si dhe shëmtim estetik si në ekspertizën e lartëcekur ortopedike e po ashtu, sipas konstatimeve të ekspertit Dr. SH.K.-Neuropsikiatër, paditësi si pasojë e lëndimeve ka pasur frikë primare dhe sekundare në kohëzgjatje të ndryshme, ashtu që gjykata duke marr parasysh natyrën e lëndimit, vendin ku është shkaktuar ky lëndim, intenzitetin e dhimbjeve dhe frikës së përjetuar dhe shëmtimin estetik në pjesën e përparme të kokës, pjesë kjo e cila nuk mbulohet në shumicën e kohës dhe me këtë vragë paditësi në qdo kohë dhe qdo sezon e ndjen veten keq për shkak të plagës shqyse, gjykata ka gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit, duke i’u aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë dhe duke e detyruar të paditurin E.B.nga GJ. që paditësit I.Q.nga GJ., t’ia paguaj shumat e specifikuara, edhe atë: për dhimbje fizike, shumë prej 1,200.00 €, për frikën e përjetuar, shumë prej 1,000.00€ dhe shëmtimit estetik shumen prej 2,000.00€, respektivisht në emër të dëmit jomaterial shumë prej 4,200.00 euro, meqë shumat e gjykuara në emër të dëmit jomaterial paraqesin një lloj satisfaksioni moral për paditësin dhe janë ekuivalente me natyrën e lëndimit. Një detyrim i tillë, bazën ligjore e ka në nenin 183 par.1 dhe 2 të po këtij ligji, ku është parashikuar se „për dhembjet e shkaktuara fizike, shpirtërore, për zvogëlim të aktivitetit jetësor, shëmtimit, cenimit të autoritetit, nderit, lirive ose të drejtave të personalitetit, vdekjes së personit të afërm si dhe frikës, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit e sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla pavarësisht nga dëmi material. Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material si dhe për rëndësinë e saj, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të mirës dhe qëllimit që i shërben ky shpërblim. Pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit-kundër të paditurit I.Q.nga GJ., në lartësi prej 800.00€ e kërkuar më tepër se shuma e gjykuar, në emër

të dëmit jomaterial edhe ate për dhimbjet fizike shuma prej 300.00€ dhe shëmtimit, shuma prej 500.00€, gjykata i ka refuzuar, ngase kërkesat e gjykuara janë ekuivalente me lëndimin e pësuar dhe qëllimin e kompensimit të dëmit jomaterial si një lloj i satisfaksionit moral për paditësin, kurse kërkesat e refuzuara nuk i pergjigjen natyrës se lëndimit.

Gjykata, ka vendosur si në pike e III-të të dispozitivit të aktgjykimit duke e aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e të paditurit-kundërpaditësit E.B.nga GJ. dhe ka detyruar paditësin-kundër të paditurin I.Q.nga GJ., që të paditurit-kundërpaditësit, në emër të kompensimit të dëmit jomaterial, të shkaktuar me datë 06.09.2020, si pasojë e lëndimeve të lehta trupore, t'ia paguaj shumat, edhe atë: për dhimbje fizike, shumën prej 300.00 €, për frikën e përjetuar, shumë prej 300.00€, respektivisht në emër të dëmit jomaterial shumën e përgjithshme prej 600.00 euro, duke u bazuar në Ekspertizen psikiatrike të pranuar në gjykatë me datë 23.11.2023 të Ekspertit gjyqësor Dr. A.C.-Psikiatër, ku eksperti ka gjetur se tek pacienti i tij E.B.nuk ka pasur frikë primare të intenzitetit jashtëzakonisht të lartë, ngase me rastin e mosmarrëveshjes dhe konfliktit fizik E.B.nuk iu ka shmangur konfliktit, kurse frika primare e intenzitetit të mesëm dhe të ulët ka qenë prezent për dy minuta, pra koha kur personi ka vendosur që të ballafaqohet me rrezikun që i kanoset, kurse frika sekundare ka zgjatur dy javë dhe është e lidhur me kohën e rikuperimit fizik dhe psikik të tij, kurse nga përmbajtja e Ekspertizës ortopedike të datës 01.11.2023 të përpiluar nga Dr. M.J.-Ortoped – Traumatolog, eksperti ka konstatuar se i padituri E.B.ka pësuar lëndime të lehta trupore, gervishje në pjesë të fytyrës, pa shëmtim estetik, por që pacienti ka pësuar dhimbje fizike të intenzitetit të lartë për 2 orë deri sa iu ka dhënë trajtimi mjekësor dhe se pas dhënies së ndihmës mjekësore nuk kemi të bëjmë ma me dhimbje të intenzitetit të lartë, por ato kalojnë në intenzitet të mesëm dhe të ulët, andaj, sipas gjykatës kërkesat e gjykuara dhe të aprovuara nga ana e gjykatës janë ekuivalente me natyrën e lëndimit dhe pasojave të tij, ngase edhe pse të kualifikuara si lëndime të lehta, të njejtat nuk kanë pasojat si lëndimet e pësuar nga paditësi I.Q. i cili siq u tha kishte lëndime në kokë nga veprimi i mjetit mekanik, kurse i padituri E. ka pasur vetëm gërvishje të fytyrës nga veprimi i mjetit të butë dhe vetëm sipërfaqësisht në fytyrë.

Gjykata, konkludon se me këto kërkesa të aprovuara arrihet qëllimi i kompensimit i përcaktuar në neni 183 të LMD-së si një lloj i satisfaksionit moral, andaj, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së të paditurit-kundërpaditësit E.B.nga GJ., përtej shumave të gjykuara edhe ate; për dhimbje fizike shuma prej 800.00€, për friken e përjetuar shuma prej 570.00€ dhe për ushqim të përforcuar shuma prej 90.00€, janë refuzuar ngase nuk i pergjigjen dëmit të pësuar si lëndim i lehtë trupor dhe në këtë shkallë të dëmit të shkaktuar nuk ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar ashtu siq ka konsideruar eksperti, pra, në këtë pjesë gjykata nuk i'a ka shprehur besimin ekspertizës, pasi që mendon se është ekzagjeruar ajo.

Gjykata ka vendosur si në pikën V-të të dispozitivit të aktgjykimit, konform nenit 256 pika b) e LPK-së, ashtu që ka vendosur që kërkesat e paditësit I.Q.nga GJ. të gjykuara në lartësi prej 4,200.00€ në emër të dëmit jomaterial, të kompensohen me kërkesat e të paditurit-kundërpaditësit E.B.nga GJ., ashtu që i padituri-kundërpaditësi E.B.detyrohet që paditësit-kundër të paditurit I.Q.nga GJ. t'ia paguaj shumën e mbetur në lartësi prej 3,600.00€, në emër të dëmit jomaterial, pasi që kërkesat e paditësit dhe të kundërpaditësit sipas kundërpadisë kompensuese mund të kompensohen reciprokisht mes tyre.

Gjykata, ka vendosur si në pikën e VI-të të dispozitivit të aktgjykimit, duke e aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e kundërpaditësit XH.B.nga GJ. dhe e ka detyruar të paditurin I.Q.nga GJ., që kundërpaditësit, në emër të kompensimit të dëmit material, të shkaktuar me datë 06.09.2020, si pasojë e dëmtimeve në veturën e markës V., tipi “Golf VII”, me targa të regjistrimit 06-110-AB, pronë e kundërpaditësit, t’ia paguajë shumën prej 430.00€, duke u bazuar në ekspertizën gjyqësor të datës 01.11.2024, meqë Eksperti Gjyqësor i Makinerisë S.Z., ka konstatuar se për riparimin e pjesëve të dëmtuara të automjetit në fjalë, i dëmtuari duhet të shpenzojë shumën prej 430.00€ dhe se këtë konstatim ekspertit e ka mbështetur në dy fatura të pagesës së riparimit edhe atë fatura nr. 007726 e datës 17.09.2020 lëshuar nga N.T.SH. „ Autometali” në fshatin K. e E.-Komuna e N dhe Faturës nr. 01317 të datës 19.09.2020 të lëshuar nga „L” sh.p.k. në Gj. si dhe në tre oferta të dhëna nga S. „ E.” në F., Servisi Autocenter „ L.” në F. dhe Servisi „ O.” në Suharekë, ku është përcaktuar se për riparimin e pjesëve të dëmtuara të automjetit të udhëtarve të cekur më lart, kundërpaditësit i duhet të paguaj shumën prej 430.00€. Gjykata ia ka shprehur besimin e plotë kësaj ekspertize pasi që e njëjta është e bazuar në prova të cilat janë të besueshme për gjykatën.

Një detyrim i tillë bazën ligjore e ka në nenin 136 parag.1 të LMD-së, ku është paraparë se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”, po ashtu me nenin 137 të këtij ligji, është paraparë se “ Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*.

Për kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, si dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.265/2020, të datës 02.12.2020, për kamatën ligjore. Në nenin 382 pika 1 dhe 2 është përcaktuar se *„Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonësës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.*

Gjykata, sa i përket shpenzimeve të procedurës ka vendosur në bazë të nenit 452.4 të LPK-së, duke marrur parasysh faktin se secila palë i ka dhënë shkas inicimit të kontestit dhe varësisht nga suksesi i tyre në këtë kontest, ashtu që shpenzimet duhet t’i bartin secila pale ve e veq.

Mbi bazën e të lartshënuarave u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJ.  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2021:187332, 18.11.2024**

Gjyqtari,  
Berat Spahiu

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.